



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 77

Prishtinë, më 14.9.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Berat Luzha, Myrvete Pantina, Heset Cakolli, Selvie Halimi.

Mungoi : Branislav Grbić, Ali Lajçi, Zulfi Merxha, Elheme Hetemi, Zef Morina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Shefki Zeqiri-MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 20.7.2010,
3. Projektligji për VSM dhe caktimi i GP për projektligjin e duhanit,
4. Konfirmimi për leximin e dytë të VNM dhe propozim-agjenda për monitorimin e Ligjit për tokat bujqësore,
5. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për çka komisioni nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 20.7.2010
Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Vërejtjet e GP për VSM dhe caktimi i GP për duhanin

Naser Rugova përshëndeti komisionin në këtë takim dhe parë pas pushimeve verore dhe njoftoi për urgjencën e dërguar nga Qeveria për projektligjet që duhet të kryhen sa më shpejt. Ai njoftoi se GP për VSM është takuar dhe kanë sjellë vërejtjet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 2

Paragrafi 1.1 në reshtin e 3 fjala “Komuniteti” zëvendësohet me **“Bashkimi”** (në gjuhën serbe duhet Evropska Unija), ndërkaq në fund, pas fjalisë “legjislative” shtohet **“rregullatore dhe administrative”** (ngase ashtu kërkohet sipas direktivës evropiane).

Paragrafi 1.5 riformulohet si vijon : **“Komisioni – nënkupton trupin e propozuar nga ministri dhe të miratuar nga Qeveria, në rastet kur vet Ministria është autoritet përgjegjës i planit ose programit.”**

Paragrafi 1.8 dhe 1.9 riformulohen si vijon :

1.8 "Ministria" nënkupton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

1.9 Ministri" nënkupton Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

Amendamenti 2

Neni 4

Paragrafi 5 në reshtin e 4 pas “programit,” riformulohet si vijon : **“Komisioni i themeluar do të kryej funksione mbikëqyrëse dhe funksione të tjera, të cilat përndryshe do të kryheshin nga ana e Ministrisë.”**

Amendamenti 3

Neni 5

Paragrafi 3, në fund pas fjalës “kriteret” fshihet teksti deri në fund dhe zëvendësohet me **“nga paragrafi 1 i këtij neni”**.

Amendamenti 4

Neni 6

Paragrafi 1 në reshtin e parë “njëzetetë (28)” bëhet **“tridhjetë (30)”**.

Paragrafi 2 pika 2.1 fjala “inspektim” zëvendësohet me **“qasje”**.

Paragrafi 2.2 riformulohet si vijon : **“informon publikun përmes ueb faqes së ministrisë dhe shpalljeve publike brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e përcaktimit. Informata për publikun duhet të përmbaj :”**.

Paragrafi 2.2.3 riformulohet si vijon : **“adresën e ueb faqes së ministrisë, ku mund të ketë qasje ose të merret kopja për përcaktimin dhe çdo deklaratë përcjellëse e arsyeve.”**

Paragrafi 3, në reshtin e parë bëhet përmirësimi gjuhësor **“autoriteti përgjegjës”**, ndërkaq në vazhdim tek paragrafi 3.1, në fund pas fjalës “arsyeshëm” shtohet **“i cili afat varet nga specifikat e planit apo programit, dhe pa pagesë”**.

Paragrafi 3.2 riformulohet si vijon : **“informon publikun përmes ueb faqes së ministrisë dhe shpalljeve publike brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i udhëzimit”**.

Paragrafi 3.2.3 riformulohet si vijon : **“adresën e ueb faqes së ministrisë, ku mund të ketë qasje ose të merret kopja për përcaktimin dhe çdo deklaratë përcjellëse e arsyeve.”**

Amendamenti 5

Neni 8

Në paragrafin 1 te reshti 5 fshihet **“dokumente relevante”**-, gjithashtu në paragrafin 2.2 në fund pas fjalës “fjalë” vëhet pika dhe fshihet teksti në vijim me thonjëza deri në fund.

Në paragrafin 2.3, 2.4 dhe paragrafi 3 fshihet fjala “e konsultuar” pas fjalës “publikun”.

Paragrafi 2.3 riformulohet : **“informon publikun lidhur me adresën e cila përfshinë ueb faqen e vet dhe ueb faqen e ministrisë, ku mund të shikohet pa pagesë ose ku mund të sigurohet kopja e dokumenteve përkatëse.”**

Amendamenti 6

Neni 9

Paragrafi 3.1 riformulohet : **“adresën në të cilin mund të ketë qasje në kopjen e draft planit ose programit si dhe draft raportit të VSM-së...”** dhe vazhdon si në projektligj.

Në paragrafin 3.4 fshihet në reshtin e parë **“ose datat”**.

Amendamenti 7

Neni 10

Paragrafi 4 riformulohet : **“Në rastet kur ministri pranon nga ndonjë shtet tjetër ndonjë kërkesë për të hyr në konsultime para miratimit...”**, dhe vazhdon si në projektligj.

Në fund pas paragrafit 5 shtohet paragrafi si vijon :

6. Gjatë interpretimit dhe zbatimit të këtij neni, autoritetet relevante bëjnë zbatimin e parimeve të kërkuara sipas Konventës ESPOO.

Amendamenti 8

Neni 11

Paragrafi 2.2 , fjala “reduktimin” zëvendësohet me **“zvogëlimin”**, ndërkaq në paragrafin 2.3 në reshtin e tretë fshihet **“për të pwrfishirw”** dhe në fund shtohet **“sipas konventës ESPOO”**.

Paragrafi 3.1 lidhet me pikën e radhës 3.1.1 si vijon : **“dhe ofron kopjen e draft planit ose programit dhe raportin përkatës të VSM-së”**.

Paragrafi 3.3 , fshihet fjalia në kllapa dhe fjala në fund “relevant” bëhet **“përkatës”**.

Paragrafi 3.4, në reshtin e 4 “njëzet e tetë ditë (28)” bëhet **“tridhjetë ditë (30)”**. Në reshtin e parafundit pas fjalës “përkatës” vëhet pikë dhe fshihet fjalia deri në fund.

Amendamenti 9

Neni 12

Në paragrafin 1, në reshtin e 6 fshihet fjalia **“mbi pjesëmarrjen e publikut dhe trupave konsultativ të debatit publik”**.

Amendamenti 10

Neni 13

Paragrafi 2, në reshtin e 3 fjala “mendimit” bëhet **“vendimit”**, ndërkaq në reshtin e 7 pas fjalës “përgjegjës” shtohet **“,Qeverinë”**. Gjithashtu kjo fjalë **“Qeverisë dhe”** shtohet në reshtin e 8 të paragrafit 3 para fjalës “Kuvendit”, në paragrafin 3.1 në reshtin e parë pas fjalës “shkruar”, dhe në paragrafin 3.2 në fillim para fjalës “Kuvendi”.

Amendamenti 11

Neni 17

Paragrafi 2 riformulohet : **“Detyrat për të mbikëqyrur zbatimin e këtij ligji do ti kryej inspektorati i ministrisë, në përputhje me ligjin”**.

Amendamenti 12

Neni 18

Fshihet titulli i nenit, mbeten dy paragrafe si në vijim :

1.VSM i planeve dhe programeve për të cilat akti i parë formal përgatitor është para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të kryhen në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-015 të Republikës së Kosovës.

2. Pjesë përbërëse të këtij ligji janë edhe shtojcat prej një deri tre.

Pas nenit 18, shtohet neni si vijon :

Neni 19

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji , shfuqizohet Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor nr.03/L-015 të Republikës së Kosovës.

Neni 19 bëhet Neni 20.

Pasi që u miratuan amendamentet, **Heset Cakolli** tha se grupi punues shqyrtoi vërejtjen e **Blerim Velës (OSCE)** për mungesën e masave ndëshkuese në këtë projektligj, për çka komisioni konsideroi se është mungesë serioze ngase kemi të bëjmë me projekte kapitale për vendin tonë (**Naser Rugova** dhe **Naim Maloku**).

Heset Cakolli (kryesues i GP) u pajtua dhe shtoi se pikrisht për këto brenga grupi punues ka kërkuar sugjerimin e komisionit.

Selvie Halimi gjithashtu u pajtua se mungesa e dispozitave ndëshkuese është mungesë serioze por ajo elaboroi duke arsyetuar ekzistimin e ligjit pa këto dispozita ngase në këtë rast vet shteti përcjell procedurën e zbatimit të ligjit. Grupi punues, vazhdoi ajo, kërkoj të shtohet një paragraf ku do të ceket se konventa ESPOO obligon të gjitha shtetet kontraktuese ti përmbahen kësaj konvente ndërkombëtare lidhur me VSM. Megjithatë ajo pranoi se arsyetimi i MMPH se një Qeveri nuk mundet të dënoj vetveten, është e mangët edhe pse në projektet e tilla për VSM involvohen gjithë sektorët qeveritar.

Naser Rugova tha se në rregull është por megjithatë mos po gabohet në teknikat e veprimit. Grupi punues (Selvie Halimi) sërish sqaroi se në këtë ligj është involvuar inspektorati i mjedisit me të gjithë resorët, derisa edhe komisioni evropian nuk ka pasur vërejtje në këtë projekt të tillë siç është. **Heset Cakolli** sugjeroi që neni 24 për gjoba i ligjit ekzistues për VSM të harmonizohet me nenet e këtij projekti dhe të inkorporohet në këtë ligj. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Të bisedohet me zyrtarët e MMPH deri të enjten rreth mundësisë së inkorporimit të nenit 24 të ligjit në fuqi për VSM për gjoba në këtë projektligj.

Nëse nuk ka mundësi të tillë të veprimit, komisioni amendamentet e propozuara të GP i miratoi dhe projektligji megjithatë procedohet më tutje tek komisionet kryesore.

Lidhur me caktimin e GP për projektligjin për prodhimin e duhanit **Naim Maloku** konstatoi se edhe pse është urgjenca për përshpejtimin e nxjerrjes së ligjeve, në këtë rast nuk bënë të ngutemi ngase këtu në këtë projekt janë të involvuar tri ministri (MTI, MMPH dhe MB) të cilat duhet të harmonizojnë qëndrimet për ti konsultuar nenet, sidomos për tregtim, ngase si tha **Shefki Zeqiri** nga ministria e bujqësisë, dispozitat për tregtim janë shtuar me insistimin e MTI-së më vonë.

Naser Rugova mbështeti vërejtjet dhe konstatoi se GP për këtë projektligj përbëhet nga : **Berat Luzha** dhe **Elheme Hetemi** bashkë me stafin dhe zyrtarët që do të ftohen nga kryesuesi i grupit punues.

4. VNM dhe propozim agjenda për monitorimin e ligjit për tokat bujqësore

Naser Rugova konfirmoi se projektligji për **Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** ka kaluar nëpër komisionet e përhershme, ndaj mund të procedohet për leximin e dytë, ndërkaq rreth propozim agjendës për monitorimin e Ligjit për Tokat Bujqësore tha se është një propozim nga **Blerim Vela (OSCE)** i cili duhet të mbështetet. **Naim Maloku** sugjeroi që kjo të bëhet një muaj më vonë (në tetor), pasi që shtatori tashmë gjysma kaloi. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Miratohet propozim agjenda për monitorimin e Ligjit për Tokat Bujqësore, dike filluar në muajin tetor-2010, pasi të konfirmohet edhe një herë nga komisioni data e caktuar.

5. Të ndryshme

Naser Rugova fillimisht elaboroi për shqetësimin e prodhuesve bujqësor, sidomos të rrushit, të cilët vazhdimisht protestojnë para institucioneve shtetërore, ndaj propozoi mbajtjen e një konference dy ditore, dita e parë me panelistët nga Bujqësia, prodhues, blegtor, vreshtar etj, ndërkaq në ditën e dytë me çështjet mjedisore në Kosovë ku do të ftohen dy ministritë dhe KEK, Sharrcem, Feronikli, shoqëri civile etj ku do të ftohet gjithsesi edhe RTK ngase ky komision ka shumë punë por shumë pak përcjellët nga mediet. Ai sugjeroi mesin e muajit tetor 2010.

Naim Maloku tha se me këtë agjendë të ngjeshur të punës së komisionit nuk ka gjasa të përgatitet kjo konferencë për një muaj, ngase faktikisht bëhet fjalë për dy konferenca (pasi që ceken dy ministritë) dhe vazhdoi me ca sugjerime jashtprocedurale duke propozuar që së pari kishte qenë mirë të pyetet ministri i bujqësisë çka mundemi bashkërisht me ndërmarr në këtë drejtim.

Naser Rugova falënderoi për këtë ide dhe propozoi për mbledhjen e radhës të ftohet ministri Blerand Stavileci ku do të debatohet për çështjet aktuale të prodhuesve të rrushit.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,30.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova